



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3298/6 Prot

Pogradec, më 25.08.2026

VENDIM

Nr. 102, datë 24.08.2026

PËR

**“MIRATIMIN E NORMAVE, KRITEREVE, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE
PËR MARRJEN ME QIRA, SIPËRFAQE TOKE/TRUALL + NDËRTESË PËR
QËLLIME MGAZINIMI DHE SHËRBIMI, PËR NEVOJA TË NDËRMARRJES SË
PARQEVE DHE REKREACIONIT PRANË BASHKISË POGRADEC”**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji Nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ligjit Nr.7850, datë 29.07.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin".

VENDOSI:

1.Të miratojë normat, kriteret, rregullat, procedurat, afatin dhe vlerën e qirasë për marrjen e sipërfaqes toke/truall ndërtesë në zonën kadastrale 1298, me sipërfaqe minimum 500 m2 dhe maksimum 700 m2, dhe me sipërfaqe ndërtesë minimum 150 m2 dhe maksimum 300 m2, të cilat do të shërbejnë për vëndosjen e automjeteve, si kamjon, traktor, eskavator dhe mjeteve të tjera ndihmëse, si dhe për përpunimin e mbejtjeve të cilat do të nxirren nga liqeni dhe më pas do të përpunohen dhe do të shndërrohen në pleh organik.

2.Të miratojë Porçedurën Konkurruese si vijon:

2.1 Struktura e posaçme e krijuar me urdhër të Drejtorit të N.P.R, të hartojë dhe të publikojë njoftimin për zhvillimin e procedurës së konkurrimit në buletin e publikimeve të Agjencisë se Prokurimit Publik dhe në këndin e publikimeve pranë Bashkisë Pogradec.

2.2 Afati i paraqitjes së ofertave të zgjasë të paktën 10 (Dhjetë) ditë që nga data e publikimit të njoftimit në buletin e APP-së.



2.3 Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i krijuar me urdhër të Drejtorit të Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit, brenda 5 (Pese) ditëve nga data e hapjes së ofertave, të shqyrtojë ofertat e kualifikuara si të regullta dhe të vlerësojë me çmim më të ulët ofertën, dhe të hartojë vendimin për renditjen e ofertuesëve.

2.4 Subjektet pjesëmarrëse në konkurrim, t'iu njihet e drejta të ankohen, me shkrim, pranë Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit, kundër vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda 7 (Shtatë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit të vendimit.

2.5 Në përfundim të afatëve të ushtrimit të së drejtës së ankimimit, kryetari i K.V.O i paraqet Drejtorit, një raport përmbledhës dhe i propozon për miratimin e fituesit të procedurës konkurruese.

2.6 Në përfundim të hapave të mësipërme, autorizohet Drejtori i Ndërmarrjes së Parqeve dhe Rekreacionit për nënshkrimin e kontratës së qirasë.

3. Kohëzgjatja e kontratës së qirasë të jetë deri në 5 vjet.

4. Për zbatimin e këtij projekt-vendimi do të ngarkohet Ndërmarrja së Parqeve dhe Rekreacionit.

ZV/KRYETARE E KËSHILLIT

Miranda OLLDASHI



1. Miratuar me 14 **vota**

2. Vota Pro 14

3. Vota Kundër 1

4. Vota Abstenim 1

5. Zbardhur më date 24.08.2026